



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 28 Datë 30.01.2018

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“LUÇENTE KONCESIONARE” SH.P.K., PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “SPATHARË” ME FUQI 1038
KW.**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2 gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Proçedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 30.01.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Luçente Koncesionare” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Spatharë” me fuqi 1038 KW,

Konstatohet se:

- Me shkresën nr. 11 Prot, datë 09.01.2018, shoqëria “Luçente Koncesionare” sh.p.k., ka paraqitur në ERE një kërkesë për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga Hec “Spatharë” me fuqi 1038 KW.
- Nga analiza e bërë dokumentacionit të paraqitur në këtë aplikim rezulton se, shoqëria “Luçente Koncesionare” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike” si më poshtë:
- Format i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “e”, “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.4.1, 4.4.2, 4.4.3, 4.4.4, 4.4.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 7, pika 2, (Delegimi i të drejtave të Aplikuesit), gërmat “a” (prokuren e aplikuesit per perfaqesimin e tij) dhe “b” (b. vërtetim që i deleguari përgjegjes nuk është përfshirë në një proces të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata.)
- Nenin 8, pika 3, (Dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesi duhet të jetë në gjuhën shqipe, origjinal ose fotokopje e noterizuar ndërsa vërtetimet dhe deklaratat nga organet e tjera duhet të jenë lëshuar jo më parë se 1 muaj nga momenti i paraqitjes së aplikimit.)
- Nenin 9 pika 2, gërma “d”, (Vërtetim qe personi dhe drejtuesit kryesorë te tij ne rastin e personave juridik nuk jane te përfshirë ne nje proces penal te filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata).
- Nenin 9, pika 2 gërma “f”, (Marrëveshja e Koncesionit, mungesa e faqjes së fundit të saj me nënshkrimet e palëve);
- Nenin 9, pika 3 gërma “c”, (dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit), do të njoftohet subjekti që ti plotësojë ato brenda afateve që përcakton *“Rregullorja për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”*.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Luçente Koncesionare” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Spatharë” me fuqi të instaluar 1038 KW.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kërkesa për rishikimin e këtij vendimi, mund të bëhet në ERE brenda 7 ditëve kalendarike.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit AHMETI